

“VLERËSIMI DHE PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE TË PSIKOLOGJISË DHE PEDAGOGJISË”- WORKSHOP I PËRBASHKËT I UNIVERSITETEVE TË TIRANËS, SHKODRËS, ELBASANIT DHE KORÇËS

Në datat 5-6 Tetor 2017, pranë mjediseve të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, të Universitetit “Fan.S.Noli” u zhvillua workshopi për vlerësimin dhe perspektivën e zhvillimit të programeve të psikologjisë dhe pedagogjisë në Universitetet e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës dhe Korçës.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte analizimi i risive akademike të programeve që ofrohen në të gjithë Universitetet pjesëmarrëse, për formimin e specialistëve të rinj në fushat e edukimit dhe psikologjisë. Fjalën përshëndetëse e mbajtën Dekan i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Prof. dr. Gjergji Pendavinji; si edhe rektori i Universitetit “Fan S. Noli”, Prof. Dr. Ali Jashari. Gjatë takimit u ngritën disa grupe pune, të përbërë nga pedagogë dhe specialist të fushave përkatëse, me synim zhvillimin dhe përshtatjen e programeve në degën e edukimit dhe psikologjisë, për të ofruar diploma konkurruese dhe komplementare në tregun e punës.

Ky workshop ishte një bashkëpunim i frytshëm midis disa prej universiteteve shtetërore, ku dhe përfaqësuesit e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, dhanë ekspertizën e tyre të fituar prej vitesh në formimin e profesionistëve në fushat e psikologjisë dhe pedagogjisë.



